



Data: 25 prill 2018

## Buletin Informativ

Nr.3, 2018

### Forumi Qytetar për Sigurinë, një hapësirë e re për llogaridhënien publike të Policisë së Shtetit dhe komunikimit me qytetarët

Qarku i Elbasanit ishte pikënisja e zhvillimit të Forumit Qytetar për Sigurinë publike me pjesëmarrjen e Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj, drejtuesit më të lartë të Policisë së Shtetit, deputetë të qarkut, kryebashkiakut të Elbasanit dhe 6 drejtues të njësive vendore, grupet e interesit, shoqërisë civile (një përfaqësuese e së cilës moderoi takimin) dhe rreth 400 qytetarë, përfshirë studentë e të rinj.

**Në këtë Forum, Drejtori i Drejtorisë Vendore të këtij Qarku, Altin Qato**, gjatë fjalës së tij shpjegoi rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi i qytetarëve me Policinë dhe përkrahja që i jep komuniteti punës së Policisë, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve pozitive në fushën e rendit dhe qetësisë publike.



"Forume si ky i sotmi, na japin mundësinë që edhe ne si drejtues policie, të vijmë pranë qytetarëve, të ulemi e të bashkëbisedojmë, të paraqesim para jush punën tonë të përditshme, t'ju njohim me problemistikat e tu japim zgjidhje situatave, për t'ju garantuar më shumë rend, siguri e prosperitet".

Me tej z. Qato u ndal dhe në Sigurinë Publike:

"Situata e sigurisë në Elbasan paraqitet e qetë, ku gjatë kësaj periudhe nuk kemi patur ngjarje të rënda kriminale si ndaj personit, gjithashtu edhe ndaj pronës.

Një fokus i madh i punës sonë është siguria dhe parandalimi i ngjarjeve në shkolla dhe përreth tyre, veçanërisht për

parandalimin e shpërndarjes së lëndëve narkotike. Së shpejti do të fillojë edhe vendosja e Oficerëve të Sigurisë në shkollat e Elbasanit".

Më pas Z. Qato i njohu të pranishmit me tre prioritetet kryesore që ka Policia e Shtetit, ku një nga këto është policimi në komunitet, si një filozofi e re për të krijuar një marrëdhënie të re mes Policisë dhe qytetarëve dhe një kontroll më të mirë të territorit.

Z. Altin Qato gjithashtu tha:

"Kemi shumë sfida përpara dhe këto mund të kapërcehen vetëm nëse do të kemi mbështetjen tuaj. Unë jam i interesuar që Policia të veprojë me formën më të lartë të profesionalizmit dhe integritetit, por që ta arrijmë këtë, vlerësimi juaj mbi punën tonë është i domosdoshëm, që edhe ne të dimë se si po ju shërbejmë".

Mes të tjerash ai u shpreh:

"Zyra ime është zyra juaj, komisarati është juaji dhe është aty për t'ju shërbyer qytetarëve. Për Policinë është shumë e rëndësishme që ky dialog i nisur sot, të vijojë me të njëjtën rëndësi edhe në të ardhmen".

**Gjatë forumit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu**, në fjalën e tij ka falënderuar qytetarët dhe ka kërkuar prej tyre më shumë besim dhe bashkëpunim.

Ai gjithashtu ka surprizuar të pranishmit me dy certifikata për shërbime të dalluara, për dy ish-punonjës të Policisë së Shtetit tashmë në pension, ku njëra ka qenë punonjësja e parë femër e Policisë shqiptare.

Z. Veliu theksoi se: "vetë prezenca kaq e madhe e qytetarëve të Elbasanit, këtu në këtë pallat sporti, do të shërbejë si një motiv dhe një arsye më shumë, për të gjithë efektivin e Drejtorisë Vendore Elbasan, për të përmbushur misionin, krijimin e rendit dhe sigurisë në qytetin e Elbasanit, sepse të jesh punonjës Policie është jo privilegj, por përgjegjëshmëri dhe sakrificë".



Kështu që nisur nga këto, unë do t'ju lutem ta largojmë indiferentizmin dhe të jemi më proaktivë, dhe ju lutem shumë na jepni më shumë besim, -përfundoi Z.Velii.

### Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj gjatë fjalës së tij nënvizoi se:

"Ky forum sot këtu nuk është një institucion, që do të funksionojë si i tillë. Ky forum është pikënisja për të realizuar pikërisht këtë filozofi, këtë marrëdhënie të strukturuar ndërmjet Policisë, organeve të qeverisjes vendore, komunitetit, organizatave të shoqërisë civile, komuniteteve të ndryshme fetare, me një qëllim të vetëm për të pasur më shumë rend, qetësi dhe siguri në komunitetet tona".



Në mes të tjerash ai u shpreh:

"Policia e Shtetit sot është përpara disa sfidave të rëndësishme, që kanë të bëjnë me forcimin e rendit dhe sigurisë. Policia e Shtetit, në zbatim të disa prioriteteve të rëndësishme të Qeverisë dhe shoqërisë Shqiptare është e angazhuar në disa sfida të rëndësishme. Ndër to, pa dyshim sfidat kryesore janë ato që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e fenomeneve të terrorizmit. Policia e Shtetit është e angazhuar për

t'u përballur me krimin, e në mënyrë të veçantë me krimin e organizuar. Unë jam i surprizuar jo vetëm nga pjesëmarrja, por dhe nga vlerësimet që u bënë këtu për Policinë dhe bashkëpunimi që Policia ka mundur të ndërtojë këtu me organet e Qeverisjes Vendore dhe komunitetet përkatëse.

Jemi të vendosur për ta bërë këtë gjë, por jemi po aq të sigurt se ne nuk mund ta bëjmë vetëm, pa marrëdhënien me pushtetin vendor. Me drejtuesit e bashkive, me këshillat bashkiakë, me organet e tjera të qeverisjes vendore, me Prefektin dhe ekipin e tij, me organizatat e shoqërisë civile, me komunitetet e respektuara fetare, me mësuesit dhe pedagogët, me drejtuesit e Universitetit dhe me drejtuesit e arsimit shkollor të të gjitha niveleve, me grupet e interesit.

Policimit në Komunitet, marrëdhënia që do të vendosim me aktorët e tjerë lokalë, por gjithashtu edhe forumet qytetare për sigurinë publike, në të cilat do të jemi të gjithë bashkë për të diskutuar për çështjet e sigurisë.

## Përfundon me sukses programi "Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substancave të tjera të rrezikshme në 26 shkolla 9-vjeçare të qarkut Elbasan"

Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Brendshme mbi projektin: "Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substancave të tjera të rrezikshme në shkollat 9-vjeçare".

Qëllimi i këtij programi është zbatimi i filozofisë së Policimit dhe Sigurisë në Komunitet, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve të sistemit arsimor 9-vjeçar, parandalimi i përhapjes dhe reduktimi i përdorimit të drogave dhe substancave të tjera të rrezikshme.



Temat që janë zhvilluar në kuadër të këtij programi janë: Alkooli, Duhani dhe Droga

Grupet mësimdhënëse përbëheshin nga dy oficerë Policie dhe mësues, të cilët zhvilluan një formë bashkëbisedimi interaktiv, ku nxënësit u përfshinë në diskutim rreth substancave narkotike, faktorët që i shtyjnë të rinjtë për t'i provuar, shkaqet dhe pasojat që sjellin substancat narkotike tek ata individë që i konsumojnë. Takimet janë shoqëruar me foto dhe punime të ndryshme duke përcjellë mesazhe sensibilizuese nga vetë nxënësit.

Ky program rezultoi mjaft pozitiv, pasi këto formate bashkëbisedimi, shërbejnë për të vendosur ura të forta komunikimi mes Policisë dhe shkollës, por që i shërbejnë edhe mbrojtjes së fëmijëve, familjes dhe shoqërisë, nga fenomenet negative të duhanit, alkoolit e drogës. Gjatë takimeve, përfaqësuesit e Policisë kanë ftuar nxënësit dhe mësuesit të telefonojnë në dy numrat e telefonit pa pagesë, 129 dhe 126, për çdo rast urgjent, me qëllim që Policia t'u vijë në ndihmë, por gjithashtu u kërkoi bashkëpunim atyre, që të denoncojnë edhe çdo shkelje të ligjit apo fenomen negativ, pasi e vetme, Policia nuk mund të përmbushë me sukses këtë mision

